41	16.10.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martesë midis dy shtetasve shqiptarë	17.10.2023	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Procedura për të bërë <b>shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptarë në Republikën e Shqipërisë</b> është si më poshtë vijon: Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:</p> <p>prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martesë”; fotokopje e dokumentit të identifikimit; Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martesë. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p>	E plotë	Nuk ka
42	17.10.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martesë midis nje shtetasi shqiptar	17.10.2023	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet e mëposhtme për shpalljen e martesës (të legalizuar, përkthyer dhe noterizuar): Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e Gjendjes Civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; Dokumentin / Certifikatë</p>	E plotë	Nuk ka

		dhe nje shtetasi te huaj		që vërtetohet se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martesë (vërtetim për leje lidhje martesë); Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; Fotokopje e dokumentit të identifikimit. Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: Certifikatë lindje; Certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martesë”. Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesë. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martesë / ekstrakt akt martesë) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e Gjendjes Civile në Shqipëri, në zyrën e Gjendjes Civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.		
43	18.10.2023	Kërkesë për informacion për mundësi punesimi	18.10.2023	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të parë vendet vakante ne ADISA duhet të vizitoni linkun e mëposhtëm: <a href="#">Mundësi Punesimi, Pozicione Vakante Punesimi, Punesim</a> . Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
44	18.10.2023	Kërkesë për informacion për portalin e-filing	18.10.2023	Përsëritje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoriteti tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezultojnë se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Përsëritje, Po ju drejtohem për një problem që kam hasur në website-in e e-Filing. Nuk mund të gjejë një adresë emaili ku	E deleguar	Nuk ka

				mund te shkruaja per kete problem, prandaj po ju drejtohem juve. Kam krijuar gabimisht nje deklarate te padorezuar ne Tatimin mbi te Ardhurat Personale, mirepo nuk me del nje opsion per ta fshire. A ka ndonje problem nese e le kete deklarate te padorezuar? Ju lutem me udhezoni se si duhet te veproj.		
45	19.10.2023	Kërkesë për informacion për bonusin e bebes	19.10.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për qytetin e Lushnjës, çeku i bebes tërhiqet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier.në adresën, Drejtoria Rajonale e SHSSH Fier – Lagjia “Kastrioti” Fier; Pagesat do të ekzekutohen në çdo bankë Credins. Dokumentacioni për tërheqjen e bonusit nga njëri prej prindërve është: * Certifikatë personale e bebit, me shënimin për bonusin e bebes; * Certifikatë familjare, me shënimin për bonusin e bebes; * Fotokopje e dokumentit të identifikimit të të dy prindërve; * Në rastet kur çeku do të tërhiqet nga një familjar kërkohet pajisja me prokurë të posaçme për tërheqjen e çekut të bebes. Afati ligjor i tërheqjes së bonusit të lindjes, është 1 vit nga data e lindjes së fëmijës. Pas këtij afati e drejta e përfitimit humbet. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.	E plotë	Nuk ka
46	19.10.2023	Kërkesë për informacion për legalizim dokumentash	19.10.2023	Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion ju bejme me dije se ju duhet ta drejtoni pyetjen tuaj tek institucioni kompetent ne Itali, pasi ne nuk kemi kompetence per sherbimin qe kerkoni. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
47	20.10.2023	Kërkesë për informacion për ankimim pensioni	20.10.2023	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Në datën 16 gusht 2023 është dërguar dosja e	E deleguar	Nuk ka

				ankimimit për pension në Komisionin Qendror të Ankimimit, por deri tani s'më ka ardhur asnjë përgjigje. Ku mund të interesohem për përgjigjen?		
48	22.10.2023	Kërkesë për informacion për njehsim diplome nga IAL	31.10.2023	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Përshëndetje, Kam mbaruar studimet master ne Universitetin NTU ne Britanine e Madhe. Universiteti me ka nisur diplomën dhe listen e notave me poste. Shkoj për ta noterizuar dhe perkthyer dhe me thote noterja te duhet vula apostile. Ju lutem ku e marr une kete vule apostile ne Shqiperi (Ambasade britanike ne Shqiperi, Ministri e Jashtme ne Shqiperi, Ministri Arsimi ne Shqiperi) apo ne Britani? Nderkohe une jetoj ne Shqiperi.Ju lutem nese duhet ta marr nga pala britanike, si koordinoj une me institucionet atje pasi Universiteti nuk eshte i detyruar ta beje kete vule. Ne pamundesine time per te shkuar ne Britani a e merr persiper ambasada jone atje kete proces? Si kane operuar te sapodiplomuarit e tjere ne situaten time?Ju falenderoj dhe pres me padurim pergjigjen tuaj pasi mosnjehsimi i diplomes master po me pengon me perparimin e karrieres sime ne Shqiperi.Pune te mbare!	E deleguar	Nuk ka
49	22.10.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martesë	31.10.2023	Përshëndetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se, nese passaporta juaj nuk eshte ne proces skadimi, ju mund ta perdorni ate, persa kohe nuk keni ndryshime ne mbiemrin tuaj. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.	E plotë	Nuk ka
50	23.10.2023	Kërkesë për informacion për Marrje Gen-plan (A3/A4)	31.10.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të siguruar dokumentin që u nevojitet duhet të aplikoni nga llogaria juaj në e-albania shërbimin: Marrje Gen-plan (A3/A4), në linkun e mëposhtëm: <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12428">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12428</a> Gjatë aplikimit duhet të ngarkoni një dokument ( hartë të vjetër p.sh.) që ka të bëjë me objektin për të cilin po kërkon dokumentacion. Pas aprovimit të	E plotë	Nuk ka

				<p>kërkesës, punonjësi i specializuar i AQTN-së faturon shërbimin e kërkuar. - Në këtë moment, ju mund të shikoni detajet e faturës të shërbimit për të cilin po aplikoni, duke kërkuar aplikimin tuaj nëpërmjet opsionit "Aplikimet e mia" dhe duke shtypur më pas butonin "Shfaq". - Kryeni më pas online pagesën e shërbimit duke shtypur butonin "Paguaj" dhe duke zgjedhur bankën që ofron këtë shërbim. - Pas marrjes së konfirmimit dhe të pagesës përkatëse nga AQTN-ja, punonjësi i specializuar i AQTN-së përgatit dokumentin e kërkuar dhe ju mund ta shkarkoni atë duke klikuar butonin "Dokumentet", tek ndërfaqja që ju hapet pasi kërkonte aplikimin tuaj nëpërmjet butonit "Aplikimet e mia". Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
51	23.10.2023	Kërkesë për informacion për Pagesën e taksës vjetore të mjeteve të përdorura/ mjeteve të luksit	31.10.2023	<p>Përsëritje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se e kemi përcjellë pranë AKSHI - t problematikën lidhur me pamundësinë e pagesës së taksës vjetore të mjetit online. Deri sa të zgjidhet problemi, jeni të detyruar të veproni pranë sporteve të DPSHTRR, ose pikave të kontrollit teknik. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka
52	23.10.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martese	31.10.2023	<p>Përsëritje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është <b>shpallja e martesës</b>. Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes., ama, afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1(një) vit kalendarik nga data e shpalljes. Pas kalimit të afatit 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martese. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Pra, brenda afatit 365 ditë të vlefshmërisë së shpalljes së martesës, jeni të lirë të lidhni martesën kur të dëshironi. Për çdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanal informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në të premte ne fashen orare 08.00 – 19.00.</p>	E plotë	Nuk ka

53	23.10.2023	Kërkesë për informacion për Aplikim AV0	31.10.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se për të plotësuar një AV ose e quajtur ndryshe “Akt Verifikimi” ju duhet të logoheni me të dhënat tuaja në e-Albania dhe më pas të kërkonti shërbimin që keni aplikuar së fundmi, shërbim për të cilin do të plotësoni dokumentacionin me AV. Pas kërimit të shërbimit ju duhet të klikoni “ <b>Përdor</b> ” dhe më pas do të vazhdoni në fund të faqes ku do të gjeni opsionin, Nëse do dërgoni AV të një aplikimi të mëparshëm. Plotësoni të gjitha të dhënat e nevojshme dhe më pas klikoni " DERGO". <b>Lidhur me pyetjen Tuaj, numri i referencës është numri i kërkesës që e gjeni në krye të mandatpagesës tek aplikimi i mëparshëm për të cilin po aplikoni AV.</b> Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
54	23.10.2023	Kërkesë për informacion për regjistrimin e të dhënave të ndryshuara të anije/mjeti lundrues	31.10.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se nëse mjete lundrues është blerë brenda vendit, duhet të aplikoni shërbimin: Aplikim për regjistrimin e të dhënave të ndryshuara të anije/mjeti lundrues, në linkun e mëposhtëm: <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14931">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14931</a> Punonjësi i Drejtorisë së Përgjithshme Detare (DPD) njoftohet elektronikisht për mbërritjen e dosjes së re dhe verifikon saktësinë e dokumenteve - Nëse dokumentet janë të plota, punonjësi i Drejtorisë së Përgjithshme Detare (DPD) njofton qytetarin për të sjellë me postë dokumentat origjinale. - Nëse ka pasaktësi ose mungesë dokumentesh, njofton aplikantin për pasaktësitë dhe e udhëzon për të riplotësuar praktikën e aplikimit. - Aplikanti nis me poste dokumenta origjinale drejt Drejtorisë së Përgjithshme Detare DPD - Punonjësi i kontrollon ato dhe nëse të gjitha dokumentet janë në rregull, ai përfundon procedurën për regjistrimin e të dhënave të ndryshuara për anije / mjet lundrues - Ju do të njoftoheni me e-mail dhe tek seksioni “Dokumentet e mia” në e-Albania. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

55	23.10.2023	Kërkesë për informacion për Ndryshim gjeneralitetesh	31.10.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se, nëse pas lidhjes së martesës Ju do vazhdoni të mbani mbiemrin e vajërisë, pra nuk do ndryshoni gjeneralitetet, pasaporta juaj e udhëtimit mbetet e vlefshme. Nëse merrni mbiemrin e bashkeshortit, jeni e detyruar të rinovoni dokumentet: Pasaportë biometrike, Kartë identiteti, Leje drejtimi automjeti Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
56	23.10.2023	Kërkesë për informacion për ndryshim vendbanimi	31.10.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të bërë saktësimin e adresës do logoheni me të dhënat Tuaja në e-albania dhe do te aplikoni sherbimin "Aplikim per ndryshim/Saktësim Vendbanimi" ne linkun e mëposhtëm: <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419</a> Në aplikim do ngarkoni në format PDF njërin nga dokumentet e mëposhtme që vërtetojnë pronësinë e banesës ku do jetoni: <b>Kopje të noteruar të certifikatës së pronësisë, Kontrate noteriale qeraje, Akt noterial përdorimi banese. Si edhe kartat e identitetit të secilit prej anëtarëve të familjes që do bëjnë shkëputjen bashkë me Ju.</b> Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
57	23.10.2023	Kërkesë për informacion për dokumentacion ligjor	31.10.2023	Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se ju mund te orjentojeni ne faqen tone zyrtare <a href="https://www.adisa.gov.al/i-transparences/">https://www.adisa.gov.al/i-transparences/</a> prej ku mund te aksesoni ne Programin e Transparences dokumentacionin e disponueshem lidhur me institucionin.	E plotë	Nuk ka
58	24.10.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martesë	31.10.2023	Përshëndetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni ne kanalim tone te komunikimit <b>live chat</b> ne faqen tone zyrtare <a href="https://www.adisa.gov.al">https://www.adisa.gov.al</a> nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për t'ju sqaruar hap pas hapi per rastin tuaj. Keshtu mund te kuptojme me mire rastin dhe t'ju ndihmojme ne kohe reale. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka

59	24.10.2023	Kërkesë për informacion për Rishqyrtim pensioni	31.10.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se afati ligjor i marrjes së këtij shërbimi është 30 (tridhjetë) ditë. Pas këtij afati kontrolloni Kartelën e pensionit të pleqërisë, ose shkarkoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin Vërtetim Pensioni. <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=5033">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=5033</a> . Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit	E plotë	Nuk ka
60	24.10.2023	Kërkesë për informacion për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)	31.10.2023	Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se, ju duhet te kryeni Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), ne portalin e-albania. Bashkelidhur gjeni linkun: <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477</a> . Ju bejme me dije se paraprakisht duhet te realizohet celja e trashegimise prane nje noteri. Kini parasysh qe pasi te çelet trashegimia, duhet realizuar rregjistrimi i saj prane Agjensise Shteterore te Kadastres, brenda afatit prej 30 ditesh. Per vijimesine e procedurave do ju informoj edhe noteri ku te drejtoheni. Kini ne vemendjen tuaj nese gjyshi ka patur prona ose jo, bejeni me dije noterin per te ndjekur proceduren e duhur. Ne rast se keni pyetje te metejshme lutemi te kontaktoni <a href="https://www.adisa.gov.al/">https://www.adisa.gov.al/</a> , ne live chat. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
61	24.10.2023	Kërkesë për informacion për njehsim diplome nga IAL	31.10.2023	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Të nderuara zonja, të nderuar zotërinj, në datën 17.10.2023 kam kryer aplikimin me numër MASR-2023-9269974-CJ, në platformën e-albania, për njësimin e diplomës time Bachelor, për studimet e kryera në Gjermani. Gjithashtu kam kryer edhe pagesën e kërkuar më 10.10.2023. Deri më tani nuk kam marrë asnjë përgjigje apo konfirmim nga ana juaj.Ju lutem të më jepni informacion në lidhje me kërkesën time.	E deleguar	Nuk ka

62	24.10.2023	Kërkesë për informacion për aplikim pasaporte	31.10.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije për të kryer aplikim për passaporte biometrike, ju duhet te kryeni procedurën pranë njesise se vendbanimit tuaj. Ju mund te blini kuponin ne cfaredo pike te postes shqiptare, por kryerjen e procedures duhet ta realizoni aty ku keni te rregjistruar vendbanimin tuaj, ne rastin konkret, ne Shkoder. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
63	25.10.2023	Kërkesë për informacion për leje ndërtimi	31.10.2023	Përshëndetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni ne kanal in tone te komunikimit <b>live chat</b> ne faqen tone zyrtare <a href="https://www.adisa.gov.al">https://www.adisa.gov.al</a> nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për t'ju sqaruar hap pas hapi per rastin tuaj. Keshtu mund te kuptojme me mire rastin dhe t'ju ndihmojme ne kohe reale. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
64	26.10.2023	Kërkesë për informacion për vjetërsi pune	31.10.2023	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.Mirdita, me 04.08.2023 kam derguar nje kerkesa nepermjet portalit e-albania te mamas sime per te kerkuar vitet e punes se babajt tim te vdekur me 04.07.2023. Fatkeqesisht mora një dokument në sistem që nuk i përket njësisë sonë familjare. Kërkesa e bërë është per "Vërtetim për periudha pune në ish - kooperativat bujqësore" edhe "Vërtetim për periudha pune në ndërmarrje shtetërore para datës 01.01.1994" e bashkeshortit tim te vdekur me 04.07.2023. Bashkangjitur ju lë dokumentin e pasaktë që kam marrë me 29.09.2023 nga sistemi e-albania. Faleminderit	E deleguar	Nuk ka
65	26.10.2023	Kërkesë për informacion për bursa ne arsimin parauniversitar	31.10.2023	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Pershendetje! Kjo bursa vlen dhe per nxenesit ne	E deleguar	Nuk ka

				gjimnaz te pergjithshem apo vetem profesional? Domethene cilet nxenes e perfitojne?		
66	27.10.2023	Kërkesë për informacion për Shpallje martes e midis një shte tasi shqiptar dh e një shtetasi të huaj	31.10.2023	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se hapi i parë i lidhjes së martesës, është shpallja e martesës. Ne kerkesen tuaj nuk keni cituar nese partneret jane te dy shqiptare apo nje shqiptar dhe nje i huaj. Procedura për të bërë <b>shpalljen e martesës midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj</b> është si më poshtë vijon :</p> <p>Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martesë (vërtetim për leje lidhje martesë); dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; fotokopje e dokumentit të identifikimit; Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). <b>Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: certifikatë lindje; certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martesë”;</b> Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesë. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martesë/ekstrakt akt martesë) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin.<b>Lidhur me pyetjen Tuaj, Ju bëjmë me dije se në mungesë të partnerëve në shpallje, bëhet prokurë me vulë apostile ku ju autorizoni një person të tretë ose partnerin Tuaj të bëjë shpalljen për ju. Lidhur me dokumentin e identifikimit, në shpalljen e</b></p>	E plotë	Nuk ka

				<b>martesës, pranohet vetëm karta e identitetit shqiptare brenda afatit të vlefshmërisë.</b> Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
67	27.10.2023	Kërkesë për informacion për pension familjar	31.10.2023	Përsëritje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se afati ligjor i përfitimit të shërbimit, pasi keni bërë aplikimin në e-albania është 30( tridhjetë) ditë. Nëse statusi është Përfunduar masën e pensionit e gjeni po të aplikoni shërbimin Vërtetim Pensioni. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.	E plotë	Nuk ka
68	27.10.2023	Kërkesë për informacion për dëshmi penaliteti	27.10.2023	Përsëritje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se: Nëse jeni rezident jashtë vendit, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin Aplikim për vërtetimin e verifikimit të gjendjes gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) në linkun e mëposhtem” <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12583">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12583</a> Shtetasit shqiptarë, të cilët kanë nevojë të pajisen me vërtetimin mbi gjendjen gjyqësore, pas plotësimit të formularit dhe autorizimit të nënshkruar për kryerjen e verifikimeve të nevojshme nga përfaqësues të ambasadës/konsullatës, njoftohen se aplikimi është pranuar. Shtetasi shqiptar informohet me anë të e-mail-it mbi procedurat që duhen ndjekur në vijim për: 1. Kryerjen e pagesës; 2. Dërgimin e autorizimit të nënshkruar origjinal; 3. Dërgimin e mandatin origjinal; 4. Dërgimin e një zarfi me pullë të parapaguar me adresën e shtëpisë të shënuar qartë dhe me gërma të mëdha për dërgimin e vërtetimit të gjendjes gjyqësore (Dëshmisë së Penalitetit). Vërtetimi mbi verifikimin e gjendjes gjyqësore dërgohet me postë, në adresën e shënuar nga vetë qytetari. Informimi i hapave të ndërmarra dhe njoftimi kryhet me anë të adresës elektronike (e-mail) të shënuar në formularin e aplikimit. Lidhur me pyetjen Tuaj për formën e autorizimit, Ju informojmë se nuk është format tip, por shprehja e aplikantit me shkrim se autorizon konsullin të kryejë verifikimin e gjendjes Tuaj gjyqësore. Këtë autorizim e ngarkoni si dokument në aplikim. Për çdo	E plotë	Nuk ka

				pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
69	28.10.2023	Kërkesë për informacion për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë	31.10.2023	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se për t'u regjistruar në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë, ju duhet të aplikoni online në shërbimin "Aplikim për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë", bashkëlidhur linku <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039</a></p> <p><b>Hapat e procedurës</b>- Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania; - Zgjidhni shërbimin "Aplikim për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë"; - Klikoni butonin " Përdor"; - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular; - Ju do të njoftoheni me e-mail dhe tek seksioni "Dokumentet e mia" në e-Albania për regjistrimin. <b>Dokumentacioni i nevojshëm</b></p> <p><i>Dokumente që ngarkohen nga aplikanti:</i> - Leje e ushtrimit të profesionit lëshuar nga Urdhri Profesional përkatës.Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p>	E plotë	Nuk ka
70	28.10.2023	Kërkesë për informacion për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë	31.10.2023	<p>Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se per tu regjistruar ne programin e certifikimit te profesionisteve te shendetesise, ju duhet te aplikoni online ne sherbimin "Aplikim per regjistrimin ne programin e certifikimit te profesionisteve te shendetesise", bashkëlidhur linku <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039</a></p> <p><b>Hapat e procedures</b> - Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania; - Zgjidhni shërbimin "Aplikim për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë"; - Klikoni butonin " Përdor"; - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular; - Ju do të njoftoheni me e-mail dhe tek seksioni "Dokumentet e mia" në e-Albania për regjistrimin. <b>Dokumentacioni i nevojshëm</b></p> <p><i>Dokumente që ngarkohen nga aplikanti:</i> - Leje e ushtrimit të profesionit lëshuar nga Urdhri Profesional përkatës. <b>Kujdes! Ju bëjmë me dije se aplikimi për tu regjistruar në programin e certifikimit të</b></p>	E plotë	Nuk ka

				<b>profesionistëve të shëndetësisë, kryhet Online nëpërmjet portalit e-albania nga vetë aplikanti. Në rast se keni nevojë për asistencën tonë për kryerjen e aplikimit, apo për cdo paqartësi të mundshme, lutemi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</b>		
71	30.10.2023	Kërkesë për informacion për rregjistrim prone	31.10.2023	Përshëndetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni ne kanalim tone te komunikimit <b>live chat</b> ne faqen tone zyrtare <a href="https://www.adisa.gov.al">https://www.adisa.gov.al</a> nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për t'ju sqaruar hap pas hapi per rastin tuaj. Keshtu mund te kuptojme me mire rastin dhe t'ju ndihmojme ne kohe reale. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
72	30.10.2023	Kërkesë për informacion për pajisje me leje drejtimi	31.10.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nuk mund të dilni në qarkullim me makinë, pa pasur Lejen e Drejtimit fizikisht me vete. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
73	30.10.2023	Kërkesë për informacion për rregjistrim i aktit te lindjes	31.10.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se fëmijën e lindur jashtë vendit, për shqiptarët rezidentë, mund ta regjistroni nëpërmjet shërbimeve konsullore duke aplikuar nga llogaria e prindit të fëmijës në e-albania shërbimin: Aplikim për regjistrim fëmije, ne linkun e mëposhtem: <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9767">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9767</a> <i>Dokumentet që duhet të ngarkohen nga aplikanti:</i> - Akti i lindjes ose certifikata e lindjes së fëmijës, lëshuar nga autoritetet e huaja (i legalizuar ose pajisur me vulë apostile) - Dokumente identifikimi të prindërve (pasaportë ose kartë identiteti shqiptare) - Përktimi i aktit ose certifikatës së lindjes, i legalizuar ose pajisur me vulë apostile (nëse nuk e legalizoni apo apostiloni përktimin e certifikatës, kërkohet përktimi në gjuhën shqipe të kryhet në konsullatë, ose nëse është kryer përktimi nga përktues të licensuar, duhet që konsulli të lëshojë “vërtetim përktimi”. Tarifa e përktimit apo vërtetimit të përktimit është 10 euro për faqe dhe është detyrim i qytetarit aplikues) - Pëlqimi me deklaratë noteriale të prindit të huaj (nëse njëri nga prindërit është shtetas i huaj), për lejimin e regjistrimit	E plotë	Nuk ka

				<p>të fëmijës në Shqipëri. Nëse nuk do veproni nëpërmjet rrugës së mësipërme po Ju dërgojmë dhe procedurën e regjistrimit të fëmijës nëpërmjet të afërmëve si më poshtë vijon: Në pamundësi të paraqitjes së prindërve pranë zyrave të Gjendjes Civile të Njësisë suaj Administrative për të bërë regjistrimin e fëmijës së lindur jashtë shtetit, në regjistrin kombëtar të popullsisë në Shqipëri dhe rrjedhimisht edhe në certifikatën tuaj familjare, duhet të dërgoni pranë familjarëve tuaj këto dokumenta:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· <b>Prokurë e Posaçme për personin që do të kryejë regjistrimin dhe kopje të letërnjoftimeve elektronike të dy prindërve;</b></li> <li>· <b>Aktin e lindjes të mbajtur jashtë shtetit, i cili duhet të jetë legalizuar me vulë Apostile dhe i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.</b></li> </ul> <p>Në vijim prindi, ose personi i autorizuar, pajiset me Regjistrimin e aktit të lindjes, Certifikatën e aktit të lindjes, Certifikatën familjare dhe Certifikatën personale të të porsalindurit.</p> <p><b>Për çiftet që nuk kanë martesë zyrtare, fëmija regjistrohet në gjëndjen civile ku është e regjistruar nëna e fëmijës dhe rezulton në certifikatë me nënën. Nëse babai i fëmijës nuk është i huaj mjafton karta e identitetit të tij dhe prezenca e nënës së fëmijës me aktin e lindjes në sportelet e gjendjes civile.</b> Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
74	30.10.2023	Kërkesë për informacion për leje legalizimi	31.10.2023	<p>Pershendetje, ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se ju nuk mund te beni ndonje procedure me tej. Thjesht do prisni sa tju emetohet vendimi legalizimit. Pasi per momentin kane perparesi vetdeklarimet e viteve 2005-2006. Megjithate, ju bejme me dije se ju mund te kontrolloni here pas here ne faqen zyrtare te ASHK. Bashkelidhur linku ku mund te kontrolloni publikimet per procesin e legalizimit te pronave: <a href="https://www.ashk.gov.al/publikime/publikime/">https://www.ashk.gov.al/publikime/publikime/</a>. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka
75	31.10.2023	Kërkesë për informacion për regjistrimin në	31.10.2023	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni nga llogaria juaj në e-albania shërbimin: Aplikim për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë,</p>	E plotë	Nuk ka

		programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë		në linkun e mëposhtëm: <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039</a> Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
76	31.10.2023	Kërkesë për informacion për shërbime ASHK	31.10.2023	Pershendetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion Ju bëjmë me dije se shërbimet e ASHK - së janë gjitha online në e-albania. Nëse keni për të dërguar dokumenta, adresa është ASHK Durrës Tirana bussines Park 07, Tiranë.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e komunikimit (online chat); nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.	E plotë	Nuk ka
77	31.10.2023	Kërkesë për informacion për përfitimi i masës KEMP	31.10.2023	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Përshëndetje, Vëllai im është me aftësi ndryshe dhe nga ky titull përfiton edhe KEMP. Për arsye të gjendjes së tij ka nevojë gjithë kohën për kujdestar dhe këtë gjë e bën gjatë gjithë kohës mami. Po lexoja për procedurën e caktimit të kujdestarit, ju lutem mund të më thoni kush është procedura dhe dokumentacioni i nevojshëm për caktimin e kujdestarit?Vëllai dhe mami jetojnë në Shkodër, në cfarë institucioni duhen dorëzuar dokumentat? Për kujdestarin e personave me aftësi ndryshe ka ndonjë ndihmë ekonomike? Ju falenderoj paraprakisht për përgjigjen. Gjithë të mirat!	E deleguar	Nuk ka
78	31.10.2023	Kërkesë për informacion për kompesim raporti barrë lindje	31.10.2023	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Përshëndetje, Duke qënë se është një procedure për herë të parë nga ana ime, doja të informohesha paraprakisht për disa	E deleguar	Nuk ka

			<p>çështje: Kam një punonjëse e cila është shtatzënë dhe më ka dërguar raport 1-mujor (30 ditor), nga komisioni i mjekëve. Si duhet të veprojmë, cilat janë procedurat dhe dokumentat që duhet të dorëzojmë në mënyrë që personi në fjalë të marrë kompesimin nga ana e ISSH? Nga ISSH do marrë kompesimin e plotë prej 30 ditësh sa është raporti, apo 16 ditë, pasi 14 ditë duhet t'ia paguaj subjekti sipas kushteve të kontratës? Cilat janë dokumentat dhe procedurat që duhet të ndjek, pasi personi në fjalë të më dorëzojë raportet për barrëlindje, 35 ditë përpara dhe në vazhdim deri në 6-muaj ose 1-vit, sido që të vendosi! Është një shpërblim “Shpërblim për Lindje Fëmije”, po për këtë shpërblim cilat janë procedurat dhe dokumentet që duhet të dorëzojmë që personi ta përfitoj? Faleminderit e punë të mbarë.</p>		
--	--	--	---	--	--